



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 64179

Më: 28 maj 2024

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 28 maj 2024, në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:08 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Karanfil Haxhillari, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj, Egzona Hoxhaj, Levent Buş dhe Florent Ukaj, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mungoi: Bajram Kastrati.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Kujtim Gashi, Nënkryetar i Komunës, Sulltan Badalli drejtor i DEF, Rahim Destani - Kryesues i Komisionit për hartimin e Rregullores, si dhe OJQ-të e Mediat.

Antigona Bytyqi: Përhëndetje i nderuar nënkryetar, anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtor, zyrtarë, media, të gjithë ju të pranishëm, përhëndetje për të gjithë.

Për sot siç jeni të njoftuar edhe e keni marrë materialin me kohë kemi thirrë këtë mbledhje të radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa, prezent jemi shtatë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, kështu që mund të vazhdojmë me këtë mbledhje. Për rend dite kemi propozuar këto pika:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 22 prill 2024 (e jashtëzakonshme) dhe 26 prill 2024 (e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 001/011-53593 të datës 23 prill 2024;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.01/011-3250 dt.08.03.2012 për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për shërbime komunale në Komunën e Prizrenit;
6. Miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimeve (sipas rekomandimeve të MMPHI-së);
7. Informatë rreth raportit të punës së zyrës-njësisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, për vitin 2023.

Po fillojmë menjëherë me pikën e parë.

Pika e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 22 prill 2024 (e jashtëzakonshme) dhe 26 prill 2024 (e rregullt);

Antigona Bytyqi: A ka dikush diçka rreth procesverbaleve?

Karanfal Haxhillari: Ka gabime teknike dhe gramatikore, por janë të tejkalueshme.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, dikush tjetër, në qoftë se jo, atëherë po e hedhim në votim pikën e parë, prezent jemi tetë antarë. Kush është për që të miratohet procesbalet? Unanimisht ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e dytë.

Pika e dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Antigona Bytyqi: A ka dikush diçka me shtuar? Në qoftë se jo, atëherë ju lajmëroj që në datën 24 maj nga OJQ NOvo Koncepti dhe Asambleja Komunale e Fëmijëve, kanë bërë një kërkesë, më janë drejtuar mua që me datën 30.05, domethënë për kuvend të jetë në rend dite edhe miratimi i planit të punës që bëhet fjalë për planin e punës për ekipin për të drejtat e fëmijëve. Kanë kërku me futur dhe kanë kërkuar pasi që është edhe festa e 1 qershorit të harmonizohet me manifestimin e kësaj dite. Sa e di ky dokument i ka i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore, mirëpo si dokument është kompletuar pasi e kemi thirrë seancën, domethënë pasi e kemi thirrë seancën, plani i punës për ekipin për të drejtat e fëmijëve. Po urdhëro Egzona sepse më duket ke qenë edhe në grupin punues.

Egzona Hoxhaj: Po, faleminderit kryesuese. E ceku edhe kryesuesja, kam qenë edhe pjesë e grupit punues të këtij planit për të drejtat e fëmijëve. Është një dokument që prej ministrisë është kërkuar që edhe komunat me e pasë edhe janë të përfshira aktivitetet domethënë që kanë me u bë për me i promovu dhe me i kërku të drejtat të drejtat e fëmijëve. Në grup punues kemi qenë prej asamblesë komunale, prej organizatave që janë aktive për të drejtat e fëmijëve në komunë të Prizrenit, në të njëjtën kohë edhe prej ministrive përkatëse dhe prej drejtorive komunale përkatëse të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet çka kanë bërë këto. Kështu që është mirë ne me ja dhënë një mbështetje edhe me shti në seancën e 30 majit për shkak që dojnë me e prezantu si dokument edhe me 1 qershor kur është planifiku.

Dafina Alishani: Kush e ka formu atë komision që është zgjedh anëtari prej kuvenit, a është bë në kuvend jo?

Egzona Hoxhaj: Ky grup punues është krijuar prej vitit të kaluar realisht, njëherë kryesues i komisionit ka qenë Drejtori i Punës dhe Mirëqenies Sociale Edmondi, tani përgjegjësia ju ka bërë drejtorit aktual. Ky realisht është projekt që Nevo Koncepti ka qenë bartës i këtij projekti, domethënë përmes organizatës të atyre, po për shkak të procedurave, janë përfshirë edhe aktarët e tjerë.

Dafina Alishani: Po po, veç a e ka vendosur drejtorja këtë komision?

Egzona Hoxhaj: Ne jeni propozuar edhe prej në kuvend jemi propozuar vitin e kaluar unë jam unë jam propozuar.

Dafina Alishani: S'po e mbaj në mend!

Antigona Bytyqi: Ka qenë e financuar prej Agjensisë Suedeze apo?

Egzona Hoxhaj: Po po ama jena zgjedh në kuvend, me datë nuk e di saktë ama vitin e kaluar, më shumë se një vit ka nuk e di sakt datën cilën seancë.

Antigona Bytyqi: A kemi një propozim tjera?

Dafina Alishani: Po për hir të datës pasi që veç jemi edhe në 30 maj, atëherë mirë kishte me qenë me e shty përpara dhe me ja bë edhe domethënë me i pas mbështetje edhe fëmijët e qytetit edhe një punë pasi qenka bë për këtë grup. Atëherë ish kanë mirë me e shty edhe para 1 qershorit me u votu, ndoshta kish pasë njëfarë kuptimi ma të madh.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, dikush tjetër prej KPF-së? Atëherë në qoftë se nuk kemi, prezent jemi tetë anëtarë, po hedhi në votim propozimin është një plan vjetor tre vjeçar 2024/2027. Atëherë po e hedhi në votim, kush është për.

Dafina Alishani: Në kuadrin e zyrës kush e menaxhon këtë a është mirëqenia?

Egzona Hoxhaj: Po mirëqenia.

Antigona Bytyqi: Kush është për? Unanimisht, faleminderit. Atëherë bashkë me propozimin e ri, rendin e ditës po e hedhim në votim komplet, kush është për? Unanimisht, ju faleminderit shumë, kalojmë te pika e tretë.

Pika e tretë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 001/011-53593 të datës 23 prill 2024;

Antigona Bytyqi: Pra bëhet fjalë për pikën të cilën e kemi miratuar mbledhjen e kaluar. Po urdhëro drejtor.

Sulltan Badalli: Po faleminderit kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Pra bëhet fjalë për tejkalimin nga planifikimi i të hyrave vetanake të komunës e cila është një vlerë prej 2 milion e 487 mijë. Ka ardhur për së dyti për shkak se konsultimi me ministrinë që e kemi bë, në Ministrinë e Financave kuptohet, sepse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk e ka kthyer që s'është në rregull si të kundërligjshëm por te Ministria e Financave do sugjerime të tjera na kanë dhënë që me u fokusu në projekte që përfundojnë me këtë vlerë, jo projektet, që ne i kemi qitë disa projekte herën e parë po nuk kanë qenë të finalizuara, prapë kanë mbetur obligime ndaj atyre projekteve. Tash në tre projekte i kemi fokusuar që këto projekte me këto vlera që i kemi për bartje se vlera prapë nuk ndryshon totali, përfundojnë këta projekte edhe e kanë parë të arsyeshme ata në këtë

formë me shkuar dhe ne në bazë sugjerimeve të tyre na e pamë të arsyshme, bile ne menduam njëherë s'di a me pru edhe në kuvend, prap u konsultuam me ta, mirë thanë me e çu në kuvend se vlera nuk ndryshon ajo vlerë është e njëjtë. Veç i kemi reduktuar projektet në tre projekte, se dy projekte që janë veç janë shpronësimi i varrezave, pesë janë gjitha edhe shpronësimi i objektit të lirisë këtu, ky që është këtu. Do të thotë, në tre projekte bazë është fokusuar gjithë vlera prej 2 milion e 422.432 euro, tre projekte domethotë që me u finalizu ata projektet. Kjo ka qenë arsyeja pse edhe njëherë është dashur me i pru në kuvend.

Karanfil Haxhillari: Për shembull, rehabilitimi i infrastrukturës ku është kodi 54122, afër gjysmë milion euro te rruga Shuaip Spahiu! Ndonjëherë a e din, tash ky projekt është planifikuar, është ndarë buxhet dhe tek tash domethënë nuk ka një muaj që kanë filluar punimet. Edhe diqysh e pakapshme po më duket me nda mjete për një projekt i sapo filluar.

Sulltan Badalli: Po duhet me përfunduar projekti, aty është që ka qenë esenca, se mjetet s'kanë mjaftuar, edhe është dashtë me nda prej të hyrave të tejkalume, kështu ka qenë edhe sugjerimi i departamentit të buxhetit në Ministri të Financave që mjetet duhet të barten me projekt që finalizohet ai projekt. Jo me ndo mjete dhe me mbet prapë në vazhdimësi.

Karanfil Haxhillari: Në rregull është për varrezat, në rregull është për borxhet e mbetura në projekte, por me bajtë mjete të vitit të kaluar për një projekt të këtij viti i cili projekt veç sa ka filluar a e din tash nuk po e di qysh po i planifikoni këto projekte. Nejse në këtë rast s'ki faj ti, i ka fajet drejtoria përkatëse. Por edhe për një projekt sa ja kanë nisë me e mbi mbulu me buxhet me të bartura a e din dyqysh!

Sulltan badalli: Jo ajo është në vazhdimësi projekt, ajo është domethënë është në proces po mendoj.

Dafina Alishani: Rekomandimi i ministrisë ka qenë me i vendosë projektet të cilat përfundojnë këtë vit?

Sulltan Badalli: Duhet me përfundu, jo në këtë vit, duhet me përfundu me këtë shumë buxhetore, me këto vlera. Se ne herën e parë i kemi dërguar disa projekte, mirëpo projekte kemi nda te disa që janë, edhe ata janë në proces të punës në vazhdimësi, mirëpo ende nuk janë kryer me këtë vlerë që i kemi ndarë, kanë mbetur prapë obligime. Kështu që ata na kanë rekomanduar që duhet me u fokusu në projekte që realizohen me këtë bartje që e bëni ju. Edhe jemi obliguar që me i nda këta 3 projekte, me i ndarë vlerat, shumat që me u kryer këto projekte, kjo është.

Dafina Alishani: Po veç me sa e di unë, funksionalizimi i rrugës Adem Jashari dhe ish objekti i Lirisë, ky është një projekt i ri i cili ka ardhë rrjedhimisht prej shpronëzimit AKP-ja që na ka ba, kjo është e para. Ndërtimi i varrezave ka qenë e planifikume, nuk është i ri.

Sulltan Badalli: Jo, ky është shfrontësimi, kjo është vlera e shpensimit, se këtu dhe faturat i kemi bile të objektit të lirisë.

Dafina Alishani: Te kjo është një projekt i ri edhe ka qenë i paplanifikuar.

Sulltan Badalli: Jo, ka qenë i planifikuar.

Dafina Alishani: S'ka qenë i planifikum se nuk e keni pas prej qeverisë aprovimin, tash del zotimi që duhet me u bjo për shkak që sa përqindshi është me pagu AKP-në.

Kujtim Gashi: 20%.

Sulltan Badalli: Na është dashur patjetër me planifiku, që ka ardhë momenti tash e kemi ne në bazë të situatës qysh ka shku rrjedha me AKP-në. e kemi menduar që këtë vit duhet me u kryer edhe ne si kod buxhetor është dashtë me....

Dafina Alishani: Në rregull jemi, po du me dalë tjetër kah. Diku 2 milion euro janë të paplanifikuara apo? Këto rehabilitimi i hapësirave publike në zonën e parë kanë qenë të planifikuara, çka ka ndodhur që tash po dalin këto kaq shuma të mëdhaja të paplanifikuara këto s'po e kuptoj!

Sulltan Badalli: Sanë qenë të planifikuar se projekti nuk ka qenë një vjeçar, projekti është tre vjeçar edhe nuk ka pasur mjete në vitin e parë komplet shuma totali.

Dafina Alishani: Për shembull te e para te kodi i projektit 53820, rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit. Këtu thotë që në bazë të analizave konstatojmë që mund të realizohen punime në këtë vlerë të prezantuar për bartjen, ndërsa pjesën tjetër zotohemi ta realizojmë në vitin 2025 meqënëse ky projekt është tre vjeçar. Ndërkohë ju po thoni që duhet me u zotu për projekte që përfundojmë.

Sulltan Badalli: Po.

Dafina Alishani: A përfundon kjo në 2024-tën, a dalim në 2025-tën dhe prap barten?

Sulltan Badalli: Jo, mundet edhe me dalë në 2025-tën, varësisht punimet qysh ecin tash. Por vlera, na mjetet veç jemi tuj i nda për këtë projekt.

Dafina Alishani: Sulltan, a jeni të vetëdijshëm që shadërvani u blloku dhe njerëzit janë në hall prej këtyre punimeve.

Sulltan Badalli: Po pse u blloku këtë e kemi bë.

Dafina Alishani: Po s'është arsytim kjo, ju po doni neve me na qitë arsytime.

Sulltani Badalli: Jo more arsytim, s'është arsytim kjo. Mu për atë punë janë ndarë mjetet për mu kry, mu finalizu sepse keq ka mbete.

Dafina Alishani: Por s'po punohet Sulltan.

Sulltan Badalli: Po ka filluar puna.

Dafina Alishani: Ku ka filluar? Po bien njerëzit në gropa ku ka filluar?

Sulltan Badalli: Kanë ra tash, çka me bë.

Dafina Alishani: Qysh ka ra, s'bën me qesh, kanë ra njerëzit për shkak të mungesës së sigurisë. Unë e di që tash ju keni me u arsyetu me thonë që projekti është tre vjeçar, a njerëzve po i thoni deri në fund të vitit përfundojnë punimet.

Sulltan Badalli: Po mundet edhe me përfundu, unë s'po e përjashtoj atë.

Dafina Alishani: Po ti nëse mund të zotohesh që po kryet, e këtu 2025 i bie që kemi shumë punë na. Pse s'po e bini komplet edhe merreni me prioritet shadërvanin.

Sulltan Badalli: Po mirë de, është marrë me prioritet, derisa mjetet janë ndarë dhe po bëjmë plan ne që këto mjete me u nda me u fokusu kryesisht, se është e ndjeshme, është proces i aty qendra e qytetit për atë punë është bërë kjo edhe na ka pranuar ministria këtë punë edhe tash.

Kujtim Gashi: A bën pak me ndihmu Sulltanin te projekti i shatërvanit. Projekti tre vjeçar e nënkupton edhe pjesë të tjera jo vetëm shatarvan domethënë rrugë që e lidhhen me shatarvanin përfshi këtu edhe nënkalanë edhe çdo rrugë që shpije në shatërman ose prej shatërvenit në lagjet e caktuara. Mjetet që janë të parapame me bartje janë ekskluzivisht për shatërvanin edhe ato mendohet me u përfundu sivjet. Ndërkohë projekti tre vjeçar nënkupton pjesë të tjera të lagjes, sepse shatërvani ju e dini është në qendrën historike në zonën e parë, por zona e parë merr shumë territor edhe pjesa tjetër që është paraparë trevjeçar është në hapësirat përreth shatërvanit, kur shatërvani mendohet nëse s'ka me pas ndonjë problem të paparashikueshëm siç është rasti i prolongimit me KEDS-in, që po besoj që po bëhet një zgjidhje. Përndryshe projekti trevjeçar nënkupton pjesë të tjera të lagjës së shadërvanit. Për shadërvanin ndodhi si vjet bile mundësisht kjo pjesa e infrastruktures e kubzave mos me u krye dhe para sezonës për shkak se tani gravitojnë edhe turistë, mërgimtarë e shumë njerëz që.

Dafina Alishani: Cilën sezonë?

Kujtim Gashi: Deri në nëntor është fjala.

Sulltan Badalli: Pjesa brenda e shadërvanit, qatë është fokusi kryesor.

Adem Shabanaj: A doni me fillu me vendos kalldërm mbi kalldërm që me vendos edhe njëherë.

Kujtim Gashi: Po ajo pjesë pjesë është.

Sulltan Badalli: S'është hapësirë e madhe ajo.

Adem Shabanaj: S'mundet meu përfundu, logjikisht s'mundet me u bë.

Sulltan Badalli: S'është hapësirë e madhe.

Antigona Bytyqi: Dikush tjetër rreth kësaj pike?

Karanfil Haxhillari: çka deshta me thënë po e vazhdoj aty ku mbetëm. Pra bëhen planifikime, ndahet buxhet dhe në mes të rrugës është nevoja me miliona euro të ndahen dhe për të tjerat dhe të planifikon për shembull një zonë historike që është shumë e rëndësishme për qytetin e Prizrenit dhe të planifikohet Sulltan projekt tre vjeçar, pra tre vjet me u punu në atë vend që ka një rëndësi tepër të madhe, me të vërtetë nuk po e di kush po i planifikon këto!

Sulltan Badalli: Po tash s'di a dëgjove që tha nënkryetari.

Karanfil Haxhillari: Po me shku te kalaja me bë rrugë e shatërvanin e ke plazh edhe kjo nuk shkon.

Sulltan Badalli: Jo kjo është fokusi është te qendra, aty është tash këto mjetet që kanë.

Dafina Alishani: Cili fokus o Sulltan? Ja na s'po jetojmë në Prizren ja ju.

Sulltan Badalli: Qysh cili fokus?

Dafina Alishani: Po çfarë fokusi ke në shadërvan që sa javë s'u punu hiç.

Sulltan Badalli: S'u punu po tash punohet, se mjetet janë.

Dafina Alishani: Po a mjetet ju kanë ndalë juve?

Sulltan Badalli: Po mjetet de, ne i kemi ndarë posaçërisht për këtë.

Dafina Alishani: Qysh qoheni peshë ju me i çu kalldërëmin pa pas mjete të zotume?

Sulltan Badalli: Po ka pas mjete nuk është që s'ka pasë. Ngecjet janë të natyrës tjetër aty, por s'ka pas mjaftueshëm mjete s'ka pas se mjete pa mjete s'ka mund edhe projekti mu hap.

Dafina Alishani: Se di ja ju s'po jetoni në Prizren ose na se s'po muj me kuptu intelegjencën!

Sulltan Badalli: Jo probleme të tjera ata janë që është vonu qëi tregoj, jo Keds, jo tash si di ato detajet tash pse kanë ngecur.

Antigona Bytyqi: Florenti e ka fjalën.

Florent Ukaj: Faleminderit. Edhe unë pajtohem plotësisht me kritikën e kolegëve që u dhanë që ka ngecje në shadërvan dhe me të vërtetë është për keqardhje gjendja e cilën është shadërvani për momentin. Po nëse fokusi me të vërtetë do të jetë drejtor për atë pjesë, sidomos në atë pjesën zonën kryesore po them, edhe ne jemi që ta përkrahim këtë pikë, po ashtu edhe për varrezat do t'i bëhet një zgjidhje sa më shpejt që Prizreni ta ka një destinacion, se po dihet që është stërmmbush varrezat e qytetit dhe të bëhet njëherë e mirë një zgjidhje. Pra nëse zotoheni se fokusi edhe njëherë do të jetë sidomos në atë qendër ku u bë si plazh me të vërtetë, ne jemi që ta votojmë, por mos hajdeni

më herën tjetër me thënë jo ministria, jo na kanë tepruar mjetet, jo s'na kanë tepruar mjetet, po ta bëni një zgjidhje, sidomos para sezonit.

Sulltan Badalli: Jo kjo është komplet bëhet fjalë për atë zgjidhje me bë që po diskutojmë tash. Atëherë nëse bëhet fjalë për atë ne nuk do të jemi pengesë, po edhe duhet edhe ju duhet të ardhë me dhënë përgjegjësi në rast se nuk ndodh ashtu çka po deklaroni.

Sulltan Badalli: Kjo është që rastësisht nuk ka ardhur dy herë me votu këtu. Ne pavarësisht prej obligimeve të tjera edhe që ka, po ne jemi orientuar kryesisht në këtë pjesë këtu.

Florent Ukaj: A ka ndonjë problem tjetër që mundet me na dalë këto ditë drejtor që për mos me u punu në atë zonë.

Adem Shabanaj: E ndal KEDS-i.

Kujtim Gashi: A ban une me ndihmu pak se jam pak më në rrjedha, sepse jam duke u marrë më shumë me ta. Sa i përket komunikimit tonë me organet kompetente që e menaxhojnë qendrën historike, në kuptimin edhe të ligjit për qendrën historike dhe ligjet për trashimi këtu ka probleme të kësaj natyre. Problemi aktual është me vendosjen e sënëka-ve nga ana e KEDS-it, që nuk është problem i joni drejtpërdrejtë me KEDS-in, po është problemi i KEDS-it, në QRTK-në, që natyrisht ne jemi të involvuar indirekt në këtë farë çështje. Ky është problemi i vetëm aktualisht që është tuj u diskutuar. Ka modalitete të ndryshme, por nuk ka një zgjidhje përfundimtare. Përndryshe, sa i përket infrastrukturës, kthimit të kaldërmit, pastaj pjesës infrastrukturore të kësaj natyre nuk kemi tash. Domethënë i kemi marrë pëlqimet me kohë edhe kemi punuar me kohë, na mujmë me bë një zgjidhje edhe pa KEDS-in, e kryejmë punën tonë, pastaj KEDS-it i mbetet me vazhdu punën me QRTK-në, me ministrinë. Unë pajtohem aktualisht me vendimet edhe idetë që i ka QRTK-ja se nuk ka aty shumë opsione me u vendosë pajisje që janë ndaluar në ligj. Kështu që problemi aktual është vetëm përmes KEDS-it dhe QRTK-së. Përndryshe jo me komunën edhe QRTK-në,

Florent Ukaj: Domethënë punimet më konkretisht, punimet kur fillojnë në atë pjesën kryesore që u bë aty, kur fillojnë punimet me u punu në atë vend? Punimet kanë filluar.

Adem Shabanaj: Kur të mirren vesh me KEDS-in.

Kujtim Gashi: Na mujmë me e pritë edhe një kohë KEDS-in, edhe e tejkalojmë edhe e kryejmë punën tonë.

Florent Ukaj: Nëse s'është pengesë, pasi po mujkan me u zhvillu punimet pse s'po filloni në atë pjesë.

Kujtim Gashi: Punime ka pasur vazhdimisht nëntokësore në infrastrukturë kush i merr vesh ato. Ka pas një ndalesë të vogël që e tha dhe drejtori pak mungesë të buxhetit, sepse ai buxheti i paraparë.

Florent Ukaj: Qe edhe buxhetin po ja u votojmë, shpresoj që tash.

Kujtim Gashi: Tash buxhetin po besoj që e kemi, po besoj që prej javës së ardhshme nëse veç e kthen menjëherë ministria edhe me vazhduar punimet. Por tash edhe duhet ta kemi parasysh që ky është projekt specifik, ka telashe, nuk është projekt pat telashe. Krejt projektet kanë telashe edhe ato që fillojnë të reja e sidomos ky që edhe nuk është ditë çka ka edhe në tokë, me shumë probleme. Megjithatë po besoj që po i vjen fundi edhe këtij projekti.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, Karanfil e ka fjalën.

Karanfil Haxhillari: Në seancën e fundit, për këtë pikë të renditës, në fakt u kanë seanca e jashtëzakonshme. Unë fort mirë pata shprehur që pata thënë, nuk është një gjendje e jashtëzakonshme për me mbajtë seansë të jashtëzakonshme për këtë pikë të rendit të ditës në qoftëse ju kujtohet. Dhe ngutia e juaj na bjen prapë seanca e jashtëzakonshme po i vjen që ka ra poshtë apo? pra kot e keni mbajtë. Dhe në këtë rast po vjen prapë pika sepse me nguti vjen prapë pika e rendit të ditës për me u trajtu në seancë të zakonshme pasnesër. Unë nuk kam kundër as varrezave, e kam theksuar edhe atë ditë as, jam vetëm kundër që planifikimet nuk po bëhen mirë! Edhe tash po na qitni në lajthitje edhe neve si kuvendar t'i shqyrtojmë. Shihe, seancën e radhës gjysmën e pikave të rendit të ditës i kemi përmirësim të gabimeve të juaja, domethënë, voto, ç'voto, voto, ç'voto, përmirëso. Edhe këtë duhet ta pranojmë, të bëhemi më të sinqertë edhe me veten edhe me qytetarët.

Kujtim Gashi: Ve një replikë të shkurt. Edhe sikur t'ish kan me të rregullt prap e ke pasur qet temë. Edhe sikur t'ish kan me të rregullt, prap e kishe pas në këtë takim sepse ta ka rekomanduar ministria edhe je i obliguar me pru në kuvend. Domethënë nuk ka autoritet as drejtori as kryetari me bë një ndryshim pa kuvendin në këtë rast.

Karanfil Haxhillari: Edhe një kundër replikë sepse po në atë mbledhje, i nderumi nënkryetar tha nuk jeni në nivel! dhe në këtë rast nuk jeni ju në nivel nënkryetar dhe pranoi sepse kjo është jo niveli juaj që po e përsëritni.

Kujtim Gashi: Me të kallxu kush është më në nivel është pak gjatë e s'po du me hy.

Karanfil Haxhillari: E pra ta dimë.

Kujtim Gashi: Se ministria ka dy herë mendime për një çështje të njëjtë, por s'po du me hy në këtë temë.

Karanfil Haxhillari: Jo bre, mu për këtë pikë tash po i bjen që nivelet po ndryshojnë.

Dafina Alishani: A mundem veç edhe një lutje me i bë të gjithë ekzekutivit dhe juve ju kam bë po nuk po, Kur ka korrespondencë me ministri. çfarëdo që kërkohet prej ministrive a mundeni me na bashkangjitur në dokumente me pa qat. Unë më nuk po ju besoj.

Kujtim Gashi: Takime kanë pas fizikisht.

Dafina Alishani: Me shkrim kurgjo s'keni pas a?

Sulltan Badalli: Jo jo, fizikisht jemi kan.

Dafina Alishani: Se unë ju kam kërkuar edhe më herët, se shumë herë këtu kur kanë ardhur kërkesa duke thënë që ministria na ka kërkuar.

Kujtim Gashi: Jo patjetër kur të ka me shkresa duhet me pas ju patjetër.

Dafina Alishani: S'na kanë ardhur, gjithmonë ne duhet me kërku!

Kujtim Gashi: Në këtë rast ka pasur nja katër ose pesë takime.

Dafina Alishani: Jo për këtë rast, por takime tjera kryesisht unë po duhet gjithmonë me ju kërku korrespondencën që e keni pas me ministrinë. Më falni, po ka shumë drejtora që kanë dalë në kuvend edhe na kanë gënjyer edhe unë nuk i besoj. Çka të keni korrespondencë tash juve po ju drejtohem, po kryesuese ku ka kërkesë të ministrive ju lus me e bashkangjitë edhe korrespondencën që e ka pas ministria.

Antigona Bytyqi: Sa i përket zyrës time, çdo gjë që kam pasë ja u kemi dërguar, besoj e keni vërejtë që. Në këtë rast ka pas takime fizike.

Sulltan Badalli: Jo more se ka probleme edhe atje, ata vetë po na thonë kanë probleme edhe ata me punëtorë me mungesë. Drejtori i buxhetit bile na tha këtë herën e fundit. T'ju qojmë atje se jeni mësu me punësu edhe i ndihmoni pak.

Sulltan Badalli: I thash a t'ja u bëjmë një zgjidhje.

Kujtim Gashi: Tash jeni mësuar edhe ju, tash qaty qaty.

Sulltan Badalli: Po me të vërtetë ishte shqetësim edhe atje për punëtorë, kanë probleme s'po them në këtë rast me arsytetë këtë por përnime kishte probleme.

Dafina Alishani: Për çka?

Sulltan Badalli: Për punëtorë, disa kanë ikë jashtë, e disa e kanë lënë.

Florent Ukaj: Derisa t'i ndërrojnë, për qata.

Sulltan Badalli: Jo se një punëtor i Prizrenit me shku atje me punu për 500 euro me të vërtetë keq është.

Dafina Alishani: A e din pse? Sepse sa punëtorin e kanë gjetë që janë me kontratë e nuk e kryejnë atë punën që janë aty nëpër pozita, nuk po ke mundësi me i largu ata se po kthehen në komisione, krejt janë ato pasojat e praktikave të juaja.

Kujtim Gashi: Jo është tu bë reformë politike aty me i largu të PDK-së me i marrë të VV-së.

Dafina Alishani: Jo jo, atë ju e bëni.

Sulltan Badalli: Jo na s'guxojnë me i hjek se ata i vyjmë qysh.

Antigona Bytyqi: Ju faleminderit, po i kthehem pikës. Pra jemi te tretë, në qoftë se nuk ka dikush tjetër po e hedhim në votim që t'i rekomandohet mbledhjes. Prezent jemi tetë anëtarë, kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes ardhshme? Ju faleminderit, unanimsisht. Kalojmë te pika e katërt.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores të datës 08.03.2012 për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit,

Antigona Bytyqi: Edhe për këtë pikë besoj që materialin e keni marrë. Ju siç e dini e kemi marrë një vendim në kuvend për njohjen e gjuhës rome në përdorim zyrtar. Pastaj ka qenë e nevojshme edhe të bëhet plotësim ndryshimi i rregullores. Pasi është formuar grupi punues, i ka kryer ato punët e veta, gjithashtu ka qenë në konsultim publik, edhe dëgjimi publik është kryer. Në qoftë se keni diçka, ndonjë pyetje diçka me shtu rreth kësaj pike, për plotësimin e rregullores për përdorimin e gjuhëve?

Dafina Alishani: A ka ndryshuar ndonjë sen? e njëjta po vjen.

Antigona Bytyqi: Kjo është për gjuhët.

Dafina Alishani: Ah më fal.

Kujtim Gashi: Nëse ka mundësi Kryesuese? Akomodohet në rregullore kjo pjesa për njohjen e gjuhës në përdorim të gjuhës rome edhe nuk ka ndonjë ndryshim të madh.

Antigona Bytyqi: E kemi te neni një edhe dy.

Kujtim Gashi: Në dy nene ka plotësim, po meqë ka kaluar, ajo duhet tash me u harmonizu me rregulloren.

Antigona Bytyqi: Atëherë po e hedhim në votim edhe pikën e.

Karanfil Haxhillari: Mos duhet edhe në statut more kjo mu bë.

Kujtim Gashi: Jo jo, se gjuhët i kemi të rregulluara me rregullore.

Antigona Bytyqi: Po hedhi në votim edhe pikën e katërt. Prezent jemi tetë anëtarë, kush është që t'i rekomandohet mbledhjes? Unëanimisht, ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e pestë.

Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt - rregullore për shërbimet publike komunale në komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi: Siç e dini njëherë e ka bërë prezantimin, por e kishin lutë në pika sa më të shkurta. Pastaj nëse keni naj pyetje e parashtroni.

Karanfil Haxhillari: Po njëherë nuk u votua qekjo rregullore apo? Edhe me të vërtetë unë kam pasur kritika shumë serioze sa i përket, se në rregullore përzihen kompetencat e shumë të tjerëve.

Kujtim Gashi: Pak është keqkuptue se nuk është rregullora e shërbime publike si drejtori, është fjala si shërbim që e kanë të gjitha drejtoritë.

Dafina Alishani: Të njëjtin arsyetim e ke pas edhe mbledhjen e kalume.

Kujtim Gashi: Unë e kam kuptu qashtu, se unë s'jam i involvuar në këtë rregullore.

Dafina Alishani: Unë veç i kam dyshimet e mia që zakonisht ndodh kjo, përgjegjësitë kur përzihen mes drejtorive pastaj kur bëhet një shkelje, një drejtori e dërgon kompetencat drejtorisë tjetër, ai tjetri thotë s'është kompetenca e imja aty se ka përzierje të kompetencave. Veç këtë brengë e kam.

Rrahim Destani: Asnjë brengë mos e kemi, asnjë përzierje të kompetencave, bile janë shumë më të sqaruara kompetencat. Këtu ka të bëjë Drejtoria e Shërbimeve Publike është me menaxhim, Drejtoria e Urbanizmit ka me dhënë leje, Drejtoria e Inspektorateve ka me kontrolluar. Domethënë këto janë, kjo është krejt rregullorja që ka me funksionu edhe ky është vendimi komunal që kemi pasur me ja u dhënë një kopje, ky është 90% vendimi komunal për rregullimin e qytetit dhe shërbimeve komunale i vitit 2004. Këtu probleme kemi bazën ligjore, pse është e vjetër, jo që po na pengon, po është e vjetër, po duam dhe ka ndryshime brenda qytetit, duhet patjetër me i harmonizu dhe ligjet po ndryshojnë. Kështu që nuk kemi mundësi me e funksionalizu në tërësi vendimin. Përndryshe inspektorati komunal e ka si bazë si ligj, jo ne pse jemi, por kushdo që të jetë, ky vendim i ka rezistuar 20 vite, por besoj që edhe kjo rregullore ka me rezistuar edhe pak më shumë, për shkak se është e bazuar direkt në ligjet e Republikës së Kosovës,

Dafina Alishani: Po për shembull inputet që i kam dhënë për objektet sportive, ne kemi bord për menaxhimin e objekteve kulturore dhe sportive.

Rrahim Destani: E kam prurë një shembull e nderuara kuvendare, jemi te parku i qytetit, lojrat kanë qenë në fushën sportive të basketbollit, sot nëse don po ta sjellim. Sot fusha e basketbollit është e lirë, domethënë me intervenimin tonë, nuk kemi të bëjmë ne me menaxhim, ne kemi të bëjmë se fushat sportive nuk janë vetëm e lirisë dhe qendra sportive, por ka dhe fusha të tjera.

Dafina Alishani: Veç pak, a bënë mos me u ngut edhe veç me më dëgju. Ne kemi staf teknik për mirëmbajtjen e këtyre objekteve apo, a kemi?

Rrahim Destani: Ajo i takon të Drejtorisë së Kulturës normal.

Dafina Alishani: Tash stafin teknik nëse e ki, kush e bënë mirëmbajtjen e hapësirave të objekteve sportive?

Rrahim Destani: Stafin teknik.

Dafina Alishani: Stafin teknik apo?

Rrahim Destani: Po.

Dafina Alishani: Kush dënohet nëse nuk mirëmbahet qekjo hapësirë.

Rrahim Destani: Drejtorja edhe stafin teknik, jo inspektoriat.

Dafina Alishani: Domethënë na po krijojmë mekanizma për me i mbikëqyr stafet tona kur ki menaxhera nëpër objekte që janë përgjegjës për atë staf.

Rrahim Destani: Drejtorja e Shërbimeve publike nëse nuk e kryen inspektorati me krejt edhe inspektoratet e ministrisë edhe krejt janë të obligueshëm me bashkëpunu në të kundërtën mundet si person juridik gjithsesi i nënshtrohet ligjit edhe vetë kuvendit kjo është e rregulluar me ligj.

Dafina Alishani: Ama kjo është nonsens për mua!

Rrahim Destani: Jo mundet me qen nonsens mirëpo.

Dafina Alishani: Ta marrim për shembull qendra sportive ka menaxher, paguhet a është ashtu?

Rrahim Destani: Po.

Dafina Alishani: Ka edhe staf teknik.

Rrahim Destani: Po.

Dafina Alishani: Tash menaxheri është dashur me mbikëqyr stafin teknik apo e kryen punën në hapësirë apo? Tash inspektoriat ka me mbikëqyr një menaxher i cili nuk ka përgjegjësi në inspektoriat, ka përgjegjësi në Drejtori të Kulturës.

Rrahim Destani: Varësisht prej natyrës së punës e nderuar kolegë, varësisht prej natyrës së punës, ka inspektorat sanitar, ka inspektorat të tregut, ka inspektorat të ndryshme që e bëjnë mbikëqyrjen e shëndetit, ushqimeve të shëndetshme, shëndetit, higjenes. që mirëmbajtja e objekteve para se me filluar ndeshja, krejt ato sende që, ato gjëra që duhet i mbikëqyr. Ne kemi të bëjmë inspektorat komunal, edhe kjo rregullore ka me dëmtimin e hapësirave të objekteve sportive, nëse dëmtohet rethojat, nëse dëmtohet muri, nëse dëmtohet banjo, nëse dëmtohet shtrati ajo dyshemeja, nëse dëmtohet oaza gjelruese, ose probleme të tjera që ndodhin rreth infrastrukturës, nuk kemi të bëjmë ne. Për ato përgjegjës menaxheri kryesor që nuk e ka njoftuar inspektoratin ose organin mbikëqyrës ose kryetarin, që kryetari me marrë masa me drejtorët që janë relevant për këtë punë që janë

kompetent në këtë rast Drejtoria e Inspektorateve. Këtu është krejt kjo kjo punë që ne nuk kemi të bëjmë me menaxhimin.

Dafina Alishani: A mundesh me ma shpjegu procesin, u dëmtua një rrethojë në qendër sportive, qysh është procedura sipas kësaj rregullore?

Rrahim Destani: Qe po të tregoj. Një procesverbal, e ka dëmtuar Rahim Destani si qytetar, e shkruajmë procesverbalin, e çojmë një aktvendim, një urdhër ekzekutimi, nëse krejt këto masa nuk i ndërmerren e ndërtojmë ne me shpenzime të palës që ka bërë dëmtimin e rrethojës. Në pika të shkurtra qekjo është procedura që duhet me e përfundu një dëmtim, ose edhe njëjtë sikurse dëmtimi i rrugës që pren asfaltin dikush e shënojmë, e çojmë për kundërvajtje, i kryejmë procedurat normale deri në fund lënda ekzekutohet me urdhër ekzekutimi në bazë të ligjit të procedurës administrative.

Antigona Bytyqi: Dikush tjetër?

Dafina Alishani: Domethënë veç qekjo rregullore juve ju ka mungu për me operuar ju qysh duhet?

Rrahim Destani: Jo jo, kjo rregullore neve na ndihmon, ne kemi vendimin, mirëpo vendimi nuk është kompatibil më me të gjitha ligjet e Republikës së Kosovës. do të thotë vendimi.

Dafina Alishani: Veç kjo rregullorja është për operimin e juaj më të mirë, a është ashtu? A muj me pritë unë që inspektoriat pas qësaj rregulloreje veç në terren ka me qenë?

Rrahim Destani: Po ne jemi në terren.

Dafina Alishani: Nuk jeni në terren, po pikërisht për këtë unë po bëhen nervoz, se po na bini veç rregullore me arsyetu mosdaljen e juaj në terren.

Rrahim Destani: Jo s'ka mundësi.

Dafina Alishani: Po po, qysh s'ka mundësi në shadervan e njëjta, ju ligjin e keni, nuk e merrni parasysh ligjin për qendrën historike, keni ardhë këtu pesë muaj neve na jeni anku që s'kena rregullore s'un po operojmë. 34.38 min.

Rrahim Destani: Për qendrën historike shumë mirë shkrunë këtu në fund, ligji për qendrën historike është i caktuar në rregullore dhe nuk e kundërshton ligjin për qendrën historike, se s'ka mundësi edhe me dashtë.

Dafina Alishani: Ju s'po e rrespektoni ligjin.

Rrahim Destani: E nderuar kuvendare shiko, Ministria e Kulturës i ka dy inspektorë të trashëgimisë kulturore edhe ne kontaktojmë për çdo ditë së paku mjaft e pamundshme është mos me kontakti për problemet që janë në qendrën historike, secili në kompetencën e vetë. Inspektorati i ndërtimit i ka kompetencat e veta, inspektorati për shërbime publike në këtë rast që kemi të bëjmë ne me këtë i ka kompetencat e veta. Ata vijjnë edhe bashkëpunojnë me ne edhe na kryejnë punë

dhe detyra në kuadër të ligjit për qendrën historike të Prizrenit dhe ligjit për trashëgiminë kulturore. Do të thotë që kjo është krejt që mundet me punu.

Dafina Alishani: Ligji për qendrën historike, nuk është veç e ministrisë, është edhe e juaja.

Rrahim Destani: Po për ato po them une.

Dafina Alishani: Keni reklama që i kanë tejkalu dimensionet më shumë se 1 m² që e ke me ligj me ja ndaluar nuk ja ke ndaluar as dikujt, qetu e kam hallin unë. Nëse kjo rregullore juve ju aktivizon, me dy duar kam me e votuar. Por me ardhur prapë me thënë valla kemi mungesë të rregulloreve edhe s'po dalim në teren. Inspektori sanitar po thu, inspektori i shëndetit publik, dilni në pazar kqyrni çka janë tu ba.

Rrahim Destani: S'janë tonët, ata tash janë në agjenci për fat të keq.

Dafina Alishani: Epo tash a ka ndonjë përgjegjësi e juaja që e keni ju në këtë terren.

Rrahim Destani: Qysh s'ka përgjegjësi, ne i kemi të shkrueme përgjegjësitë këtu, normal që i mbajnë përgjegjësitë.

Karanfil Haxhillari: Edhe një pyetje e kisha pas meqënëse edhe inspektoriati edhe për Kujtimin kisha pas dashtë. Dje është rrënuar fabrika e farmakosit. A keni ndonjë informacion, a keni dhënë leje për me u rrënuar dhe çka po ndodh aty.

Kujtim Gashi: Po ka leje edhe të ministrisë.

Dafina Alishani: Cilës ministri?

Kujtim Gashi: Të Ministrisë së Kulturës.

Dafina Alishani: Jo.

Kujtim Gashi: Ti mendon qashtu.

Dafina Alishani: Jo unë s'mendoj po ju.

Kujtim Gashi: E di se unë jam kanë aty ministë, ai e ka pasur kërkesën në kohën teme e ka pas të refuzuar.

Karafil Haxhillari: E cili është qëllimi i rrënimit? Ndërtimi i banesave a?

Kujtim Gashi: Nuk e di tash.

Rrahim Destani: Jo sektori i ndërtimit ne nuk e inspektojmë tash atë.

Dafina Alishani: Qe qekjo ndodh me rregullore.

Rrahim Destani: Jo me rregullore ajo është me ligj të ndërtimit.

Dafina Alishani: Qekjo ndodhë, na s'jena kompetent.

Kujtim Gashi: Nuk nuk ka qenë i refuzuar pse atij s'i takon se e ka ble, por pse e ka pas monumentin afër nëse kanë ndërruar ndonjë sen gjatë kohës në projekt nuk e di.

Karanfil Haxhillari: Unë e di që edhe para katër vjetëve ai ka kërku leje prej komunës për me e rrënu bile jo fabrikën e re por këtë pjesën tjetër dhe nuk është nuk i është dhënë leja nga komuna. Edhe ka pas reagime shumë të fuqishme por që rrënohen objekti i ri bash fabrika ku ka punu ku janë prodhuar barnat u kanë shok për atë pjesë.

Kujtim Gashi: Për ata ai e ka ble është e veta tash, me ligj nuk ka qenë në mbrojtje.

Karanfil Haxhillari: Është privatizu veç.

Dafina Alishani: Pyetja është a ka dhënë lejen për rrënim komuna? Veç këtë pyetje e kemi?

Kujtim Gashi: Po besoj që po.

Antigona Bytyqi: Në qoftë se nuk kemi edhe diçka tjetër? Pikën e e pestë po e hedhi në votim. Prezent jemi tetë anëtarë, kush është për?

Karanfil Haxhillari: Kisha thënë me e çu në kuvend edhe le ta japin mendimin edhe kuvendarët tjerë.

Dafina Alishani: Po se veç rregullore po na mungon për me operuar inspektoriat.

Antigona Bytyqi: Unanimisht, ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e gjashtë.

Pika e gjashtë:

Miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimeve sipas rekomandimeve të ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Dafina Alishani: Edhe dilni në ortakoll, i thu kolegëve të ndërtimit le të dalin në ortakoll se prapë kanë filluar me i uzurpu hapësirat.

Antigona Bytyqi: Sipas materialit që e keni parë ka kërku pra ministria shfuqizimin e këtyre vendimeve. Si arsyetim e kanë dhënë që është dashur me marrë një përlim komuna prej ministrisë, knej në anën tjetër e kemi pas syrtarin e ministrisë prezent edhe në kuvend. Ka qenë një zyrtar në kuadër të agjensionit që është në kuadër të ministrisë, i dha sqarimet, pastaj meqë pasi kemi votu, vjen që të shfuqizohet sepse është dashur me marrë edhe një pëlqim edhe prej ministrisë.

Karanfil Haxhillari: Po i bjen krejt rrënjët, shpellat, lisat.

Antigona Bytyqi: Po edhe jemi konsultuar me ministrinë që domethënë nuk kemi nevojë sikur që kemi marrë vendim veç e veç me i votuar, për shfuqizim me nje vendim. Kush është që ti rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e shtatë.

Pika e shatë:

Informatë rreth raportit të punës së zyrës-njesisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, për vitin 2023.

Antigona Bytyqi: siç e thash edhe në fillim s'ka mundur me ardhë, ka qenë njëherë në KPF, për në kuvend vjen me prezantu. Kush është që t'i rekomandohet pika e shtatë mbledhjes? Unanimisht, faleminderit. Kalojmë te pika e fundit.

Pika e tetë:

Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës (2024-2026);

Antigona Bytyqi: pikën e fundit besoj s'kemi çka me diskutu pikën e tetë për propozimin e ri, po materialin e kemi. kush është për? Unanimisht, faleminderit. Sikur zakonisht e qesim para informatës. Ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen dhe shihemi në seancën e radhës.

Përfundoi në ora 10:57



**Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi**